

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike,me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen juridike të paditëses A. “ A.” me seli në P.,të cilin me autorizim e përfaqësoj avokati D. R. nga P.,kundër të të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës-KEK me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqësoj O. K. nga P., për pagesën e borxhit në shumën prej 23.510,60 euro,në seancën e mbajtur më dt.27.10.2015, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses dhe përfaqësues i paditurës, ndërsa pas marrjës së fjalës përfundimatre nga palët ndërgjyqëse, me datë 12.11.2015 ka marrë këtë:

### A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. “ A.” me seli në P. dhe,

I.DETYROHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës-KEK me seli në Prishtinë ,që paditëses A. “ A.” me seli në P. ,t’ia paguajë borxhin kryesor në shumë prej 23.510,60 € (njëzet e tri mijë e pesëqind e dhjetë euro e gjashtëdhjet cent),së bashku me normën e kamatës vjetore në lartësi prej 3,5 %, e cila do të llogaritet nga data 01.02.2009 e deri në pagesën definitive të borxhit,të gjitha në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga data e pranimit të këtij aktgjykimi,nën kërcnimin e përmbarimit me detyrim.

II.DETYROHET e paditura që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës civile në shumën e përgjithshme prej 1.418.00 euro,në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Paditësja A. “ A.” me seli në P. , me datën 24.12,2009, ka ushtruar pranë kësaj Gjykate padi lidhur me borxhin në vlerë prej 23.510,60 euro kundër të paditurit Korporata Energjetike e Kosovës-KEK me seli në Prishtinë ,me kamatë ligjore prej 3.5% duke filluar nga data 01.02.2009 e deri nëpagesën definitive, njëherit ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin IV.C.nr.7/2012 të datës 27.03.2012 kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e kishte detyruar të paditurin që në emër të borxhit t;ia paguaj shumën prej 23.510,60euro me kamatë ligjore prej 3.5% duke filluar nga data 01.02.2009 e deri në pagesën definitive,si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 694,00euro.

Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë e paditura kishte ushtruar ankesë në bazë të të cilës Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ae.nr.394/12, dt.30.09.2013, ankesën e paditurit e ka pranuar dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim.

I autorizuari i paditësi gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ka mbetur pranë kërkesëpadisë dhe parashtrësave dhe ka theksuar se me të paditurën ka qenë në mardhënie detyrimore në bazë të kontratës së shitëblerjes së mallrave me c'rast paditësi të paditurit ia ka liferuar mallin sipas kontratës nr.5151 të datës 04.09.2008, dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovon kërkespadin e paditësit si të bazuar,shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I autorizuari i paditurit gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ka mbetur pranë parashtrësave dhe kundërshtimeve të tij duke shtuar se malli nuk është pranuar dhe se nuk ka procesverbal për pranimin e mallit dhe mbi këtë bazë ka kërkuar që kërkespadia e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar.Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata për të vendosur lidhur me këtë qështje kontestimore ka administruar këto prova si në vijim: kontrata me nr.5151 të datës 04.09.2008, fletëregjistrimin e biznesit të paditësit me nr. *numri i biznesit...*, fatura me nr.02/12/2008 e datës 12.01.2009, shkresën elektronike e datës 15.12.2008,shkresa elektronike e datës 12.01.2009,shkresa elektronike e datës 01.03.2009,dëshmia e dëshmitarit M. K.,inxhnjeri i makinerisë i punësuar tek e paditura, njoftimi pa datë,ekspertiza e makinerisë nga eksperti F. K. e datës 29.12.2014, shkresat elektronike e datës 14.05.2015, 13.05.2015, 12.05.2015, shkresë e KEK-ut e datës 11.06.2009, kërkesa rreth furnizimit me fryrsa të ajrit,kërkesa e datës 17.04.2007,shkresa e njoftimit për dhënje të kontratës të datës 01.09.2008,formulari i tenderit i dt. 18.08.2008.

Në këtë çështje kontestimore pas shqyrtimit,analizimit dhe administrimit të provave të lartë cekura Gjykata gjenë se në mesë të palëve nuk është kontestuse fakti se ka ekzistuar një kontratë për furnizimin me fryrësa të ajrit për PKU NEA 50 TCA sipas projektit me nr.KCB C-02-0259 A5-08-35-121 nuk ishte kontestuse se liferimi lidhur me kontratë do të ishte 6-8 javë pas nënshkrimit të kontratës .

Nuk është kontestuse fakti se fryrësit e ajrit ishin dërguar nga paditësi dhe ishin shkarkuar në depon e të paditurit me që rastë present kanë qenë depositët dhe punëtorët tjerë.

Nuk është kontestuese fakti se faktura dhe fletëdërgesa e mallit nuk është nënshkruar nga e paditura dhe nuk ka arsye se pse ato nuk janë nënshkruar për faktin që dërgesa-malli është deponuar në depon e të paditurës.

Në këtë çështje civile juridike ishin kontestuese se a e reklamoi dhe a e kundërshtoi pranimin e fryrësit të ajrit pasi ajo është shkarkuar në depon e të paditurës . A është hartuar do një procesverbal lidhur me vretjet apo pranimin e mallit .Po ashtu kontestuese ishte se e paditura a e reklamoi në një mënyrë mallin e porositur tek e paditësi apo tek zyra e prokurimit për cka është paraparë edhe në kontratë .

Madje në nenin 29.4 të kontratës parshihet se në rast se zyrtari i prokurimit në afatin prej 30 ditësh nuk ka arritë të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose ta refuzoj kërkesën e kontraktuesit do të konsiderohet se certifikata e pranimit është lëshuar në ditën e fundit të asaj periudhe.

Nuk është kontestuese edhe kjo rrethanë se malli i porositur është shkarkuar në depon e të paditurës dhe se aty gjindet që nga viti 2008-ta , dhe se e paditura nuk e ka kthyer mallin tek dërguesi.

Gjykata duke i vlerësuar të gjitha provat e administruar dhe ka gjetë këtë gjendje faktike: E paditura edhe paditësi kanë lidhë kontratë për furnizim me fryrësit e ajrit sikur u cek më lartë e në bazë të projektit të shënuar më lartë në këtë aktgjykim. Paditësi e ka liferuar respektivisht e ka furnizuar të paditurën me objektin e kontratës në afatin e paraparë sipas kontratës nenit 1 pika 1.2 të kontratës.Objekti i kontratës fryrësit e ajrit janë shkarkuar në depon e të paditurës .Nuk është nënshkruar pranimin e faturës e as fletëdorëzimin e mallit nga e paditura. Arsyet nuk janë cekë fillim por ato janë cekë pasi që paditësi ka kërkuar pagesën për shërbimin e ofruar.Po ashtu nga e paditura nuk është hartuar as një procesverbal mbi pranimin e mallit apo procesverbal për vëretjet ndaj mallit, ajo që është me rëndësi e paditura nuk e ka lajmëruar zyren e prokurimit në afatin e paraparë me kontratë për lëshimin e certifikatës për pranimin e mallit. E paditura po ashtu nuk e ka reklamuar me shkrim mallin e pranuar. E paditura as që ka ngritë iniciativ për evidentimin e vretjeve apo për ta konstatuar vretjet bashkarisht me paditësit.Malli i porositur gjindet në depon e të paditurës dhe ai nuk është kthyer tek paditësi me vretje cka mund të nënkuptohet se e paditura e ka pranuar mallin në mënyrë të heshtur.

Gjykata ka pas parasysh edhe ekspertizën e ekspertit F. K. i cili ka konstatuar se me datën 11.12.2014 ka qenë tek e paditura dhe atje në depon e tyre dhe ka bërë fotografimin e këtyre paisjeve të sjellura nga kontraktuesi-paditësi sipas kontratës së lartë përmendur. Ka konstatuar se paditësi në ofertë ka ofruar fryrësit e ajrit me karakteristikat sipas kërkesës së shpallur me tender. Ka konstatuar ,poashtu se pozicioni 2 ka të bashkangjitur një fletë të prospektit ku numri i rrotullimeve është 1372 rrot/min që është për 93 rrotollime në minut më i vogël se numri i rrotollime që do të duhen të ishin e që fuqia është më e madhe për 3.5 kilovat. Poashtu eksperti ka cekur se me kontratë është lënë mundësia e interpretimit alternativ të tipeve të këtyre fryrësve të ajrit. Eksperti në mendimin e vet ka cekur edhe rrethanën se përfundimisht ka munguar vullneti nga ana e të paditurës për faktin se qështja teknike kontestuse nuk ka qenë të pa zgjedhëshme mandje futja e fryrësve të ajrit në mënyrë alternative në kontratë as që ka qenë kështu në tenderin e publikuar dhe që të dy palët kanë pasur pozicionet e parabarta për krijimin e kushteve për këtë situatë. Po ashtu ka cek ekspertin se është e pa kuptueshme nga ana e të paditurës mbajtja e paisjeve një kohë kaq të gjatë dhe mospagesa e tyre.

Gjykata është e vetëdijshme se çështjen nuk e zgjedhë dhe as nuk e gjykon eksperti i makinerisë.

Kështu duke pas parasyshë provat e administruar edhe të shqyrtuar ,duke pas parasyshë edhe kontratën në mesë palëve në kontest si dhe konstatimi dhe mendimin e ekspertit Gjykata gjen se kërkespadia e paditësit është e bazuar për këto arsye:

Sipas kontratës neni 29.4 është obligim-detyrim i të paditurës që në rast vretjeve dhe mos dorëzimit-furnizimit të mjeteve të kërkuara sipas kontratës të lajmëroj zyrtarin e prokurimit me qëllim që të mos ta lëshoj certifikatën e pranimit sepse sipas këtij neni nuk do të transportohet e as nuk do të dorëzohej malli deri sa kontraktuesi ta ketë pranuar udhërin e dorëzimit nga zyrtari i prokurimit. Sipas këtij neni po ashtu kontraktuesi do të jetë përgjegjës për dorëzimin në vendin e pranimit të të gjitha furnizimet dhe paisjet të furnizuesit që janë të nevojshme për qëllime të kontratës . Në vazhdim të këtij neni po ashtu konstatohet se nëse zyrtari i prokurimit nuk arrin të lëshoj certifikatën e pranimit të përkohshme ose ta refuzoi kërkesën e kontraktuesit mbrenda 30 ditësh do të konsiderohet se e ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe. Kështu kontraktuesi –furnezuesi paisjet e kontraktuara me faktur dhe fletëdorëzim i ka dërguar në vendin e pranimit tek e paditura dhe ka pritë afatin e përcaktuar prej 30 ditësh që të lëshohet certifikata e pranimit. Një certifikatë e pranimit e as certifikat të refuzimit sipas këtij neni të kontratës 29.4 zyra e prokurimit nuk e ka lëshuar ashtu që konsiderohet se ekziston certifikata e pranimit të mallit edhe pse nuk është

nënshkruar fletëdërgesa e mallit e as fatura sepse kjo rrethan nuk është paraparë me kontratë. Dorëzimi i paisjeve –respektivisht pranimi dhe mirëmbatja e paisjeve janë paraparë në mënyrë specifike me kontratën e lidhur në mesë palëve kontestuse .

Andaj Gjykata konsideron se paisjet për të cilat është lidhë kontrata janë dorëzuar dhe pranuar nga kërkuesi i shërbimit-zyra e prokurimit.Gjykata ka vlerësuar vretjet e Gjykatës së Apelit e cila ka kërkuar që të vërtetohen nëse ekziston procesverbali për pranimin – dorëzimin e mallit dhe a është dorëzuar malli personit të cilën do ta bënte sigurimin fizik të tij.Gjykata konsideron kontrata është përmbush për vetë faktin malli-paisjet janë dorëzuar në depon e paditurës ku është bërë sigurimi fizik i mallit eksperti ka vërtetuar faktin se malli gjindet ende në depo ajo është fotografuar.

E paditura nuk ka paraqit me shkrim as një vretje, nuk e ka lajmëruar zyren e prokurimit për ta refuzuar pranimin respektivisht për ta lëshuar certifikatën e refuzimit.E meqë zyrja e prokurimit në afatin prej 30 ditësh të paraparë sipas kontratës nuk ka lëshuar certifikatën për refuzimin apo pranimin sipas vetë kontratës konsiderohet se malli është pranuar. Me faktin se malli është pranuar konsiderohet se është përmbush kontrata në tërësi.

Paditësi e ka deponuar kërkesën për pagesë,repsektivisht për përmbushjen e kontratës e me atë e ka dorëzuar edhe fakturën edhe fletëdërgesën. Por me që e paditura dhe zyra e prokurimit nuk kanë reaguar në afatin në kontratë dhe nuk kanë marrë certifikatë për refuzim, nuk kanë reklamuar me shkrim arsyet e mos pranimit rrjedhmisht nga kjo rrjedhë se kontrata është përmbushë në menyrën të heshtur sikurse parashihet në LMD-në por edhe për vetë faktin se ashtu edhe paraparë në nenin 29.4 të kontratës.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës dhe ka gjet se ata janë të pabazuara për arsye të cekura më lartë sepse e paditura ka pas detyrim ta refuzoj pranimin e mallit me shkrim por edhe duke mos lejuar që ai mallë të depunohet në depon e tij ka pas për detyrim që në rast të vretjeve menjëher ta lajmëroj zyrtarin e prokurimit i cili në afat prej 30 ditësh do të lëshohet një certifikatë për refuzim të pranimit. Gjitha këto e paditura i ka heshtur repsektivisht nuk ka reaguar në afatin e kuptushëm ashtu që konsiderohet se malli është pranuar dhe dorëzuar nga paditësi dhe me këtë është përmbushë kontrata nga paditësi.

Gjykata ka refuzuar propozimin e të paditurës lidhur me dëgjimin e dëshmitarëve – punëtorëve të tij si jo relevante me qenëse këta dëshmitar nuk do të kontribonin në dryshimin e kësaj çështje faktike sepse nuk është kontestuse se malli gjindet në depo e të paditurës fizikisht është siguruar, nuk është kontestuse as fakti se nuk ekziston një procesverbal mbi pranimin e mallit .

Krucjale për vendosjen e kësaj çështje ishte mos zbatimi i nenit 29.4 të kontratës nga ana e të paditurës dhe kjo ka bërë që të konsiderohet se malli – paisjet janë dorëzuar dhe pranuar nga e paditura . Po ashtu nuk është zbatuar as nenin 30.4 të të njejtës kontratë nga e paditura ku parshihet se malli i refuzuar kontraktuesi-paditësi do ta heqë nga vendi i pranimit nëse këtë e kërkon zyrtari i prokurimit mbrenda një periudhe që ai e specifikon .

Andaj, nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe duke ju referuar nenit 454.1,516.1,17 lidhur me nenin 262 të LMD-së .

Meqenëse i padituri, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, gjykata e detyroj të paditurën që t’ia paguaj paditësit, shumën e gjykuar së bashku me normën e kamatës, në lartësi prej 3,5%, ashtu siç ka kërkuar përfaqësuesi i paditësit.Lartësia e kamatës në rastin konkret, i referohet shkallës së kamatës, të cilën e paguajnë bankat afariste në Republikën e Kosovës, për mjetet e deponuara pa destinim dhe për periudhën kohore të deponimit, me shumë se për një vit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi, dhe atë: për hartimin e propozimin e përmbartimit/padisë shumën prej 208.00euro,për taksën e propozimit për përmbartim shumën prej 118.00€, për pjesëmarrje në pesë seanca 3(3x101)shumën prej 303.00 €,për pjesëmarrjen e 3 seanca në shumë prej 405,00euro , për ekspertiz shumën prej 150.00euro,për aktgjykimin e parë shumën prej 117.00euro,si dhe për këtë aktgjykim shumën prek 117.00euro të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1.418.00 €.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
-Departamenti për Çështje Ekonomike-  
III.C.547 /2013 me date 12.11.2015

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve,duke llogaritur nga dita e pranimit të të njëjtit,duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë,përmes kësaj gjykate.